

Për një Mesdhe



pa! hedhurina.



www.unep.org



www.unepmap.org



www.helmepea.gr



www.mio-ecsde.org



www.cleanupgreece.org.gr

Për një Mesdhe pa hedhurina.

Hedhurinat detare janë mbeturinat që prodhohen nga veprimtaria njerëzore si në toke ashtu dhe në det e që përfundojnë në mjedisin detar. Sende plastike, gome, letre, metalike, druri dhe qelqi lundrojnë në sipërfaqe apo nën sipërfaqen e detit, shfaqen në plazhe apo vendosen në fundin e detit.

Deti Mesdhe përballet me problemin serioz të hedhurinave në det dhe nëse nuk ndërmerren veprime nga të gjithë ne si dhe nga organizatat kompetente për të parandaluar, pakësuar dhe eliminuar këtë

lloj ndotje, gjëndja do të përkeqësohet vazhdimisht.

Nga vijnë hedhurinat detare?

Burimet kryesore të hedhurinave detare janë aktivitetet shtëpiake, industriale, bujqësore, dhe të transportit detar, të cilat rastësisht ose me vetëdije, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, hedhin në det mbeturinat që ato prodhojnë. Këto mbeturina mund të përshkojnë rrugë të gjatë që nga burimi i hedhjes deri në det për shkak të shirave, erës dhe rrymave detare.

Ndikimet e hedhurinave në ekosistemin detar dhe bregdetar

Edhe vendet më të largëta të Mesdheut preken nga hedhurinat detare, të cilat shëmtojnë peisazhin dhe mund të


dëmtojnë ekosistemin detar. Ndotësit që vijnë nga mbeturinat detare treten në ujrë dhe shirave, të lumenjve dhe në det dhe mund të hyjnë në zinxhirin ushqimor.

Kafshët detare si peshqit, delfinët, balenat, fokat dhe shpendët dëmtohen seriozisht nga hedhurinat detare sepse mund të ngecin në to, plagosen prej tyre ose i marrin gabimisht për ushqim. Pasojat mund të jenë vdekjeprurëse. Hedhurinat detare mund të shkaktojnë prerje vdekjeprurëse, ngordhjen e tyre, kufizimin e lëvizjeve, mungesë ajri, mbytje, helmim, ose ngordhje nga uria.

Tek njerëzit

Hedhurinat detare ndikojnë tek të gjithë ne. Të gjithë paguajmë kostot e problemeve që ato shkaktojnë:

- Janë të rrezikshme për shëndetin tonë, shkaktojnë infeksione, plagosje e prerje (p.sh. mbajtëset e mbeturinave toksike, xhamat e thyer e kanoçet, konservat e hapura, shiringat, etj)
- Dëmtojnë estetikën e peisazhit duke ndikuar negativisht në gjëndjen tonë shpirtërore.
- Pengojnë ardhjen e turistëve duke ndikuar në jetën ekonomike të komuniteteve bregdetare të varura nga turizmi.
- Shkaktojnë dëme në paisjet e peshkimit, elikat e skafeve duke rënduar ekonominë industriale dhe atë peshkimit
- Shkaktojnë një shpenzim të konsiderueshem për taksapaguesit dhe autoritetet lokale për pastrimin e dhe depozitim të tyre.



Prejardhja e ndotjeve që përfundojnë në Mesdhe

80% nga veprimtari tokësore: nga derdhjet e lumenjve, derdhjet e kanalizimeve të ujërave të zeza, mbeturina që shtyen nga erërat, mbeturina industriale dhe fusha depozitimi të pakontrolluara të mbetjeve urbane, mbeturina të hedhura në plazhen.
20% nga veprimtari detare: anije transporti ose pasagjerësh (p.sh. skafe, tragete), nga skafe peshkimi, amatote ose profesionistë (rrjeta, filspanje, kutira të ndryshme), mbeturina nga platformat e nxjerrjes së naftës ose gazit natyror.



Secili nga ne mund të ndihmojë në mbajtjen pastër të detit tonë të Mesdheut nga mbeturinat që ne prodhojmë.

Bëhu qytetar i përgjegjshëm:

- Hidhni gjithmonë mbeturinat tuaja në koshat e caktuara dhe mos i lini ato në breg të detit, e as mos flakni hedhurinat në det. Mbeturinat në rrugë ose në kanalizime ka shumë të ngjarë të përfundojnë në det.
- Prodhoni sa më pak mbeturina kur udhëtoni ose kur shkoni në plazh: vendosini ushqimet në kuti të ripërdorueshme. Në përgjithësi, pakësoni, ripërdorni dhe ricikloni mbeturinat kurdoherë që është e mundur.
- Hidhni bishtat e cigareve me kujdes



(p.sh., në një kuti bosh cigareash që ju e merrni me vete për këtë qëllim) : ato ndikojnë në cilësinë e ujit dhe mund të dëmtojnë jetën në det.

- Loboni që administrata lokale të vendosë kosha për mbeturina në breg të detit dhe ti mirëmbajë ato.
- Jepni shëmbullin tuaj dhe kërkoni nga të tjerët të respektojnë mjedisin detar dhe bregdetar.
- Anëtarësohuni në grupe mjedisore dhe merrni pjesë në pastrimin e bregdetit, në përpjekjet kombëtare dhe ndërkombëtare të monitorimit të tij dhe në informimin dhe ndërgjegjësimin qytetar.

Turizëm:

- Risni ndërgjegjësimin mjedisor të të punësuarve dhe të turistëve.
- Vendosni kosha mbeturinash dhe tavla për cigare në vende kyce të hotelit apo restaurantit tuaj si dhe në plazhet më të afërta dhe siguroni që ato të zbrazen, pastrohen dhe mirëmbahen rregullisht.
- Pastroni bregdetin dhe mbështesni nisma të tjera të ndërgjegjësimin qytetar mjedisor.
- Zvogëloni vëllimin e mbeturinave



që prodhoni (nga shërbime, paketime ushqimesh etj).

- Zhvilloni dhe merrni pjesë në programe riciklimi.

Peshkatarë amatorë dhe profesionistë

- Përdorni paisje peshkimi dhe ambalazhime të biodegradueshme sa herë të mundni dhe ku të mundni.
- Mblidhni mbeturinat tuaja dhe i vendosni në koshat e caktuara kur të mbrini në breg.
- Kërkoni nga Administrata Lokale dhe Rojet Bregdetare krijimin e vendeve të caktuara për hedhjen e mbeturinave në porte dhe plazhe.
- Organizatat dhe shoqatat e ndryshme duhen të edukojnë në mënyrë të vazhdueshme anëtarët e tyre për rëndësinë e sjelljes së mbeturinave në port në vend që të hidhen në det.

Industri:

- Zhvilloni inisiativa të produkteve të pastra.
- Filloni një skemë të administrimit të gjelbër të zyrës.
- Zhvilloni programe ripërdorimi dhe riciklimi që në burim.

- Prezantoni skema të administrimit të integruar të mbeturinave.
- Trainoni dhe sensibilizoni respektivisht stafin tuaj.

Anije transporti dhe pasagjerësh të të gjitha madhësive (përfshi anije turistike dhe tragete)

- Zhvilloni dhe zbatoni një Plan për Administrimin e Mbeturinave dhe rinovoni në mënyrë të vazhdueshme informacionin në Librin e Rregjistrimit të Mbeturinave.
- Risni ndërgjegjësimin mjedisor të ekuipazhit nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme.
- Përfshi tema mjedisore në programet e shkollave detare.
- Vendosni tabela informative dhe lloje të ndryshme informacioni në vende kyce në bord në mënyrë që të parandaloni flakjen në det të mbeturinave si nga ekuipazhi ashtu dhe nga pasagjerët.
- Vendosni në bordin e anijes kosha dhe tavla të përshtatshme për të zvogëluar sasinë e mbeturinave që rrembehen nga era.
- Pakësoni vëllimin e mbeturinave tuaja nga shërbime apo paketime ushqimore etj.
- Depozitoni mbeturinat tuaja në port vetëm në vendet e caktuara për to.

Autoritetet (qeveritare, rajonale, lokale, portuale, etj)

- Organizoni fushata ndërgjegjësimi dhe programe edukimi për të gjitha palët e interesuara duke u përqëndruar në lidhjet midis burimeve ujore dhe mjedisit detar.
- Organizoni monitorimin e vazhdueshëm dhe mbledhjen e mbeturinave në plazhe dhe porte detare. Bashkëpunimi midis autoriteteve portuale dhe administratës lokale është shumë i domosdoshëm.
- Ngrini një sistem të integruar të menaxhimit të mbetjeve bashkiake duke i dhënë përparësi uljes së sasisë së mbeturinave, riciklimit dhe depozitimit të

sigurtë të tyre.

- Zbatoni skema të menaxhimit të integruar të zonës bregdetare ku të përcaktohet gjithashtu përfshirja e palëve të interesuara.
- Integroni veprimtaritë lokale me prioritetet, programet dhe strategjitë rajonale dhe globale.
- Siguroni mbështetje financiare për veprime parandaluese.
- Siguroni infrastrukturën e portit për depozitim të sigurtë të mbeturinave nga anijet, skafet dhe anijeve të peshkimit.

Koshat e përmasave e llojeve të ndryshme janë një mjet i zakonshëm për depozitim të mbeturinave. Sidoqoftë, nuk është e mjaftueshme vetëm vendosja e tyre në plazhe e porte. Boshatisja dhe pastrimi i tyre në mënyrë të vazhdueshme është gjithashtu tepër i rëndësishëm. Monitorimi i rregullt e mirëadministrimi i tyre është i nevojshëm. Çështjet kyç për tu adresuar: Kush i mbledh mbeturinat? Kur? Ku shkojnë?

Me shumë informacion mund të gjeni

Programi Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Plani i Veprimit për Mesdheun (UNEP/MAP):
www.unep.org dhe
www.unepmap.org

Shoqata Greke e Mbrojtjes së Mjedisit Detar (HELMPEA):
www.helmepa.gr,
www.helmepajunior.gr

Shoqata Mjedisore Clean-Up Greqi :
www.cleanupgreece.org,gr

Zyra Mesdhetare për Informacion Mjedisor, Kulture dhe Zhvillim të Qendrueshem (MIO-ECSDE):
www.mio-ecsde.org

Sa kohë u duhet mbeturinave në det për tu dekompozuar?

Burimi: The Ocean Conservancy, "Pocket Guide to Marine Debris", 2006

shishe qelqi 1 milion vjet	gota plastike 50 vjet	letër dylli 3 muaj
filspanjë 600 vjet	kuti konservash 50 vjet	mbeturina molle 2 muaj
shishe plastike 450 vjet	qese plastike 10-20 vjet	gazetë 6 javë
kanaçe alumini 80-200 vjet	filter cigare 1-5 vjet	lëkurë portokalli 2-5 javë
gomë këpucësh 50-80 vjet	rroba të leshta 1-5 vjet	picata letre 2-4 javë
prodhime nailoni 30-40 vjet	kompensatë 1-3 vjet	

